



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1666/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPN Arbëria Com me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditues të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.122/22 të datës 29.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.122/22 i datës 29.06.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.122/22 të datës 29.06.2023, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadija e paditësit NPN Arbëria Com me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Prishtinë, ashtu që: a) Anulohet si i kundërligjshëm vendimi i shkallës së dytë nr.protok.471/2019 I dt.13.08.2019 i nxjerr nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, b) Anulohet pjesërisht si i kundërligjshëm vendimi mbi shqiptimin e gjobës nr.protok.135/2019 dt.22.05.2019 përkatësisht pika 2 e vendimit me të cilën është vendosur që paditësi është përgjegjës për : “mos zbatimin e dispozitës ligjore të nenit 23 par.4 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, e sanksionuar me nenin 25 par.7 i po të njëjtit ligj i shqiptohet gjobë në lartësi prej tre mijë e peqëqind (3,500) euro, II Mbetet në fuqi pjesa tjetër e vendimit mbi shqiptimin e gjobës me nr.protok.135/2019 i datës 22.05.2019, III Ky Aktgjykim i zëvendëson pjesët e anuluarat të vendimeve dhe ka karakter detyrues, IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e të paditurës, Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të

drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet në tërsi si e bazuar ankesa e paditurës, të Prishtet aktgjykimi KA.nr.122/22 dt.29.06.2023 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, Mbetet në fuqi vendimi i të paditues nr.protok.471/2019 dt.13.08.2019 dhe vendimi per shqiptimin e gjobës nr.135/2019 dt.22.05.2019.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi NPN Arbëria Com me seli në Prishtinë, ka ushtruar padi në gjykatë duke inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, (MPMS) respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr.471/2019 dt.13.08.2019 dhe vendimin nr.135/2019 datës 22.05.2019 të paditurës Inspektoratit të Punës, me arsyetimin se vendimet e kundërshtuara me padi janë të pa drejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Dhoma e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 26.06.2023 ( në mungesë të palëve ndërgjyqëse neni 41 i LKA-së), pasi vlerësoi vendimet e kundërshtuara dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë duke u bazuar në provat siç janë: aktvendimet kontestuese të paditurës, procesverbali per shqyrtim votim, raportet zyrtare të inspektoratit të punës, si dhe shkresat tjera, andaj duke u bazuar në provat e cekura më lartë, dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, Dhoma e shkallës së parë, vendosi që ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata referohet ne nenin 23 par.1,2,3 dhe 4 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, dhe në raportet zyrtare nr.97/2019 dt.20.03.2019 dhe nr.116/2019 dt.06.05.2019, të paditues, nga të cilat është vërtetuar gjendja faktike e inspektimit të procesit të punës së paditësit në sigurimin e kushteve të punës, gjatë ndërtimit të objektit në rrugën Driton Islami në Ferizaj. Gjykata konstaton se e paditura gabimisht ka zbatuar nenin 23 par.4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, pasi që në asnjërin nga raportet e administruara si prova nuk është konstatuar se ka pasur aksident në punë, dhe paditësi nuk mund të ngarkohet me asnjë shkelje nga neni 23 i këtij Ligji, për çka gjykata anuloi gjobën e shqiptuar për shkeljen e nenit 23 par.4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e nenit 23 agrafi 1,2,3, dhe

4 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Dhoma e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me shkeljet ligjore që ka zbatuar e paditura me rastin e vendimmarrjes në procedurën administrative kur paditësit i ka shqiptuar gjobën administrative për mos zbatim të dispozitës së nenit 5 paragrafi 1 i Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, e cila shkelje ligjore rezulton nga vizitat inspektuese e konstatuar nga raportet inspektuese, nr.97/2019 dt.20.03.2019 dhe nr.116/2019 dt.06.05.2019, të paditurës.

Kolegji vlerësoi se me të drejt dhoma e shkallës së parë ka vërtetuar shkeljen ligjore nga neni 5 paragrafi 1 i Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, që parasheh: *punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës*, pasi që edhe përkundër vërejtjeve të dhëna nga e paditura gjatë inspektimit të procesit të punës së paditësit, i njëjti nuk kishte vendosur mbrojtëse anësore që do të mundësonin siguri të punësuarit, por kishte vendosur skele vetëm në katin e katërt dhe të pestë, ku punëtorët ishin në rrezik të lartë nga rënia nga lartësia. Gjithashtu dhoma e shkallës së parë ka vepruar drejt kur me aktgjykimin e ankimuar ka anuluar pjesën e vendimeve kontestuese të paditurës përkatësisht ka anuluar shqiptimin e gjobës në lartësi prej 3,500.00€ ndaj paditësit, për shkak të mos zbatimit të nenit 23 par.4 të i Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast nuk gjen zbatim neni 23 i Ligjit nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, dhe me të drejt dhoma e shkallës së parë ka anuluar gjobën e shqiptuar nga e paditura në bazë të kësaj dispozite ligjore, sepse e paditura në asnjërin nga raportet inspektuese të administruara si provë nr.97/2019 dt.20.03.2019 dhe nr.116/2019 dt.06.05.2019, me rastin e vizitave tek paditësi, nuk është konstatuar se ka pasur aksident në punë, dhe në këtë rast nuk mund të ngarkohet paditësi me shkelje ligjore nga neni 23 paragrafi 4 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Në arsyetimet e vendimeve të paditurës nr.471/2019 dt.13.08.2019 dhe vendimin nr.135/2019 datës 22.05.2019, nuk janë dhënë shpjegime faktike, konkrete për të arsyetuar se si ka ardh deri te zbatimi i kësaj dispozite ligjore, mungojnë faktet e shkaktimit të lëndimeve apo vdekjes së të punësuarve sikurse parasheh ligji.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e shkallës së parë nuk i mori parasysh faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes sa i përket anulimit të vendimit mbi shqiptimin e gjobës, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në ligj, sepse dhoma e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, dhe vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve kontestuese te paditurës, me të drejt ka aprovuar pjesërisht padinë e paditësit, dhe në anën tjetër e përfaqësuesja e paditurës në ankesë dhe as në procedurën e konfliktit administrativ, nuk ka dëshmuar para gjykatës përmes raporteve zyrtare te inspektoratit nr.471/2019 dt.13.08.2019 dhe vendimin nr.135/2019 datës 22.05.2019, se ka ndodhur aksident apo lëndime në punë, por janë konstatuar vetëm shkelje te dispozitave ligjore, për shkak të mos ndërmarrjes së masave për parandalimin e rreziqeve për punë nga neni 5 par.1 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Kolegji i vlerëson si të drejt aktgjykimin e atakuar me të cilin Dhoma e shkallës së parë, ka lënë në fuqi vendimin mbi shqiptimin e gjobës nr.protok.135/2019 dt.22.05.2019, për shkak të mos zbatimit të dispozitës ligjore nga neni 5 paragrafi 1 i Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duke i shqiptuar paditësit gjobën në lartësi prej 3,500.00€, në bazë të nenit 25 paragrafi 2 i të njëjtit Ligj.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase është nuk cënuar ligji në dëm të paditurës, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, gjeti se Dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1666/23 datë 08.02.2024

Kryetar i kolegjit,  
Krenar Berisha